




Projekti "Margina Obscura"  
është përkrahur nga Bashkimi Evropian



# KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të  
personave me handicap në  
Republikën e Maqedonisë me  
vështrim mbi të drejtën në  
mbrojtjen shëndetësore

**Polio Plus**  
Lëvizje kundër handicapit





**ПОЛИО ПЛУС**  
движење против  
хендикеп



Publikimi “**Kah lundron kjo anije**” Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore është përgatitur në kuadër të projektit: Margina Obscura – çështja e handicap në aderimin drejt Bashkimit Evropian. Synimi kryesor i këtij projekti është të fuqizojë sektorin civil nëpërmjet Zërit të Vetëm të Organizatave të Personave me Handikap gjatë krijimit të politikave, vendimmarrjeve dhe fuqizimit të dialogut civil dhe politik.

Publikimi është përgatitur me përkrahje financiare të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Polio Plus dhe, në asnjë mënyrë, nuk i pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian

## **KAH PO LUNDRON KJO ANIJE**

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore



Mendimet që janë shprehur këtu u takojnë autorëve dhe nuk i pasqyrojnë qëndrimet e Polio Plus

Publikimi mund të riprodhohet për dedikime edukative, në çfarëdo mënyre, pa pagesë. Gjatë kopjimit për qëllime tjera, për përdorim në publikime tjera ose për përkthim dhe adaptim duhet të sigurohet leje paraprake nga botuesit

Publikimi është në dispozicion në formë elektronike në [www.polio-plus.org.mk](http://www.polio-plus.org.mk)



**KAH PO LUNDRON KJO ANIJE**  
Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap  
në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të  
drejtën në mbrojtjen shëndetësore

## **PËRMBAJTJA**

### **“KAH LUNDRON KJO ANIJE” DEMISTIFIKIMI I TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME HANDIKAP NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË ME VËSHTRIM MBI TË DREJTËN NË MBROJTJEN SHËNDETËSORE**

#### **Botues**

Polio Plus – lëvizje kundër handicapit

#### **Për Botuesin**

Zvonko Shavreski

#### **Përkthimi, Lektura**

Oz dizajn

#### **Shtyp**

HONOR PEÇAT

#### **Dizajni dhe përpunimi tekniko-grafik**

Ognjen Fidanoski

#### **Tirazhi** 500 ekzemplarë

Viti 2018

IP – Katalogjizimi në publikim

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare “Shën Kliment Ohridski”, Shkup

ISBN 978-608-4608-27-1

© Polio Plus – lëvizje kundër handicapit

Hyrje ..... 6

#### **KREU I**

STANDARDET JURIDIKE NDËRKOMBËTARE ..... 10

1. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Handikap pranë OKB-së ..... 12

2. Pikëpamje përfundimtare të Raportit Inicial të Republikës së Maqedonisë nga Komiteti mbi të Drejtat e Personave me Handikap ..... 16

#### **KREU II**

KORNIZA LIGJORE NACIONALE ..... 24

1. Legjislacioni nacional dhe harmonizimi i tij me KDPH ..... 25

#### **KREU III**

DEMISTIFIKIMI I ÇËSHTJES E HANDIKAPIT NË REALIZIMIN E TË DREJTËS MBROJTJES SOCIALE ..... 30

1. Objektivi, lënda dhe shembulli i hulumtimit ..... 31

2. Analiza kuantitative dhe kualitative e përgjigjeve të pyetësorëve ..... 36

Konkluzione dhe rekomandime ..... 56

Bibliografia ..... 62

# HYRJE



**KAH PO LUNDRON KJO ANIJE**  
Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap  
në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të  
drejtën në mbrojtjen shëndetësore

## HYRJE

Polio Plus – lëvizje kundër handicap, në kuadër të projektit “Margina Obscura – çështja e handicap në aderimin drejt BE-së”, financuar nga Bashkimi Evropian, në periudhën mars-nëntor të vitit 2018 ka përpiluar Analizën me titull “Kah lundron kjo anije” Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore (në tekstin e mëtejme: Analiza).

Analiza ka për qëllim të grumbullojë informacione dhe të vërejë se cila është pikëpamja e komunitetit me handicap në realizimin e së drejtës për mbrojtje shëndetësore, nëse të njëjtit i gëzojnë këto të drejta në mënyrë të barabartë si dhe të interpretojë të njëjtat në dritën e detyrimeve të shtetit në zbatimin e KDPH në kontekstin nacional. Për këto arsye, ishte sfidë që, në një vend, të realizohet shqyrtimi i gjendjeve të personave me handicap në realizimin e këtyre të drejtave në përgjithësi,

specifikave, të cilat i rregullon KDPH si nga karakteri material ashtu edhe nga karakteri teknik.


Botimi është përpiluar me aplikimin e metodologjisë së kombinuar e cila përbëhet nga shqyrtimi i literaturës dhe dokumenteve, analizës së 1000 pyetësorëve të marrë nga personat me handicap dhe prindërit e fëmijëve me handicap, grupet e fokusit dhe intervistave të gjysmë strukturuara.

Përveç kësaj, e njëjta sqaron rëndësinë, fushëveprimin, si dhe pyetjet dhe diskutimet e hapura për KDPH dhe paraqet pikëpamjet e Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Handikap pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara (në tekstin e mëtejme: OKB) me qëllim të nxjerrjes së konkluzioneve dhe rekomandimeve për avancimin e situatave.

Analiza përbëhet prej katër kapitujve:

**Kreu I** - jep pasqyrë për të drejtën për drejtës për mbrojtje shëndetësore të personave me handicap në përputhje





## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handikap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

---

---

# HYRJE

me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Handikap, duke shpjeguar përmbajtjen dhe interpretimin e kësaj të drejte nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Handikap.

**Kreu II** – e analizon situatën në mënyrë indikative në nivel kombëtar nga aspekti i harmonizimit të kornizës legjislative me KDPH. Në të njëjtin janë përfshirë edhe pikëpamjet dhe raportet ekzistuese në këtë sferë.

**Kreu III** – e analizon gjendjen në terren rreth asaj se si është perceptimi i komunitetit me handikap, sa i përket ushtrimit të së drejtave në sferën e mbrojtje shëndetësore.

**Kreu IV** – i përmbledh të gjitha konkluzionet nga tre kapitujt e mëparshëm e jep rekomandime që kanë të bëjnë me hapat që shteti duhet të ndërmarrë për të harmonizuar legjislacionin dhe për të ndryshuar praktikën në lidhje me ushtrimin e së drejtës për mbrojtje shëndetësore.

Ky publikim duhet të shërbejë si mjet për përpilimin e programeve, masave dhe politikave sistemore për ndryshimin e ndërgjegjes kolektive mbi këtë çështje, si dhe për të kontribuar në harmonizimin e kornizës legjislative me KDPH-në.

# KREU I

## STANDARDET

## JURIDIKE NDËRKOMBËTARE



**KAH PO LUNDRON KJO ANIJE**  
Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap  
në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të  
drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU I

Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Personave me Handikap dhe Protokollin Fakultativ i saj u miratuan me konsensus në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (në tekstin e mëtejshme OKB) në mbledhjen e saj të 61-të, të mbajtur më 13 dhjetor të vitit 2006, me Rezolutën A/RES/61/106<sup>1</sup>. Aktualisht, 162 shtete e kanë nënshkruar Konventën, ndërsa 177 shtete janë palë kontraktuese. Ndërsa, nga ana tjetër, 92 shtete e kanë nënshkruar Protokollin fakultativ dhe 92 shtete e kanë ratifikuar të njëjtën<sup>2</sup>.

KDPH është përgjigje nga bashkësia ndërkombëtare e historisë së gjatë të diskriminimit, përjashtimit dhe dehumanizimit të personave me handicap. Ajo thekson se pakica më e madhe në botë duhet t'i gëzojë të njëjtat të drejta dhe mundësi, sikurse të gjithë të tjerët.

Ajo mbulon shumë fusha në të cilat diskriminohen personat me handicap, përfshirë qasjen në drejtësi, pjesëmarrjen në jetën publike dhe politike, arsimin, punësimin, ndalimin e torturës, shfrytëzimin dhe dhunën, si dhe lirinë e lëvizjes.

Republika e Maqedonisë e ka nënshkruar KDPH më 30 mars të vitit 2007, ndërsa të njëjtën e ka ratifikuar më 5 dhjetor të vitit 2011. Për më tepër, shteti e ka nënshkruar Protokollin Fakultativ të Konventës më 29 korrik të vitit 2009 dhe e ka ratifikuar më 5 dhjetor të vitit 2011<sup>3</sup>. Instrumentet për ratifikim janë deponuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara më 29 dhjetor të vitit 2011.


Sipas nenit 118 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë<sup>4</sup>, dispozitat e KDPH-së zbatohen direkt në legjisla-

<sup>1</sup>[Shih: Rezoluta është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 13 Dhjetor të vitit 2006, 24 janar të vitit 2007. Në dispozicion në: <[https://treaties.un.org/doc/source/docs/A\\_RES\\_61\\_106-E.pdf](https://treaties.un.org/doc/source/docs/A_RES_61_106-E.pdf) > ]

<sup>2</sup>[Kjo situatë është prej nëntorit të vitit 2018. Për më shumë informacione për statusin e nënshkrimit dhe ratifikimit të KDPH mund të merren në: <[http://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtsg\\_no=IV-15&chapter=4&lang=en](http://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtsg_no=IV-15&chapter=4&lang=en)> ]

<sup>3</sup>[Shih: Ligji për ratifikimin e Konventës për të drejtat e personave me invaliditet dhe Protokollin fakultativ të Konventës për të drejtat e personave me invaliditet, Kuvendi i RM-së, viti 2011, faqe 19, mund të merret në: <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/ED1FF6FC1C8A1F4A8F36F48EFDE95E55.pdf>> ]

<sup>4</sup>[Shih: Publikimi: “Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, me amendamentet e kushtetutës I – XXXII”, NP Gazeta Zyrtare e RM-së, faqe 55, edicioni 55, në dispozicion në: <<http://www.slvesnik.com.mk/content/Ustav%20na%20RM%20-%20makedonski%20-%20FINALEN%202011.pdf>> ]



## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU I

cion, duke përfshirë edhe gjykatat kombëtare, të cilat, me kalimin e kohës, duhet të mundësojnë krijimin e një praktike të qëndrueshme gjyqësore.

## 1. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Handikap pranë OKB-së

Sipas KDPH (neni 25) personat me handicap kanë të drejtë të gëzojnë standardin më të lartë të mundshëm të shëndetit, pa diskriminim, në bazë të handicapit<sup>5</sup>. Në këtë kontekst, shëndeti definohej si “gjendje mirëqenies së plotë fizike, mentale dhe sociale dhe jo vetëm mungesë të sëmundjes ose sëmundje”<sup>6</sup>. E një rëndësie esenciale është që të regjistrohet se KDPH thekson se aftësia e kufizuar nuk është gjendje mjekësore, por se e njëjta del nga shoqëria, që me infrastrukturën e vet u pamundëson personave me handicap në mënyrë të plotë dhe efikase të marrin pjesë në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.

E drejta për shëndetin në nenin 25 duhet të interpretohet në kontekst të parimeve themelore të theksuara në nenin 3 të KDPH. Këto parime janë gjithëpërfshirëse. Shtetet, pas ratifikimit të KDPH, detyrohen që të sigurojnë barazi dhe mbrojtje nga diskriminimi. Detyrimin që të garantohet mbrojtje nga diskriminimi, përveç se nga KDPH, shtetet e kanë edhe nga Konventa Ndërkombëtare mbi Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK).

Detyrimin për të garantuar mbrojtjen nga diskriminimi, shteti duhet ta sigurojë menjëherë – “pavarësisht të nivelit të resurseve në dispozicion”. Komiteti për të Drejtat Ekonomike, sociale dhe kulturore (KDESK) thekson se “mos-diskriminimi është detyrim i menjëherëshëm për të gjitha shtetet, pavarësisht resurseve, sepse “shumë masa, siç janë: shumica e strategjive dhe programeve të dedikuara për mënjanimin e diskri-

minimit, që kanë të bëjnë me shëndetin, mund të realizohen me resurse minimale”<sup>7</sup>.

Neni 25 i përforcon parimet nga neni 12 i KDPH që kanë të bëjnë me lirinë e sjelljes së vendimeve, në lidhje me mbrojtjen shëndetësore të dikujt, në të cilën theksohet se shtetet duhet t’u kërkojnë punonjësve shëndetësorë të sigurojnë kualitetin e njëjtë për personat me handicap si të tjerët, duke përfshirë edhe në bazë të pëlqimit të lirë dhe informues me mes tjerash, ngritje të vetëdijes për të drejtat e njeriut, dinjitetit, autonomisë dhe nevojave të personave me handicap, përmes trajnimit dhe publikimit të standardeve etike si për mbrojtjen shëndetësore publike ashtu edhe për atë private.

Dështimi që të respektohet pavarësia, autonomia dhe dinjiteti i personave me handicap në lidhje me vendimet

## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU I

mjekësore çojnë deri në shkeljen e të drejtave të njeriut. Edhe kur ndërhyrjet mjekësore nuk paraqesin torturë ose trajtim tjetër jonjerëzor, nëse të njëjtat janë bërë pa pëlqim të informuar dhe pjesëmarrje aktive të pacientit me handicap, ato paraqesin shkelje të të drejtave të njeriut dhe etikës mjekësore.


Në kontekst të pëlqimit të informuar (neni 25 (g)), KDPH parasheh të drejtën e pëlqimit, me qëllim që të sigurohet gëzimi i të drejtave nga mundimi, trajtimi dhe dënimi mizor, jonjerëzor dhe nënçmues (neni 15 (1) KDPH). Përveç kësaj, neni 12 e përmban të drejtën e “Njohjes së barabartë para ligjit”. Në këtë drejtim edhe KDPH-ja kërkon nga ana e shteteve të prezantojnë modelin sjelljes së mbështetur të vendimeve (neni 12, KDPH, Komenti i përgjithshëm numër 1 i Komitetit për të Drejtat e Personave me Handikap 2014a<sup>8</sup>).

<sup>5</sup>[Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Konventa për të Drejtat e Personave me Handikap, A / RES / 61/106, neni 25. E gjeni në: < <http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRPD/Pages/ConventionRight-sPersonsWithDisabilities.aspx> ]

<sup>6</sup>[Organizata Botërore e Shëndetësisë, “Definicioni për shëndetin”. E gjeni në: < [Http://www.who.int/about/definition/en/print.html](http://www.who.int/about/definition/en/print.html). > ]

<sup>7</sup>[Komiteti i KB për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Komenti i përgjithshëm nr. 14: E drejta e standardit më të lartë të arritur për shëndetin, E/C.12/2000/4 (11.08.2000). E gjeni në: <http://www2.ohchr.org/english/bodies/cescr/comments.htm> . ]

[ CRPD Committee (2014a) General Comment 1, Equal Recognition before the Law. Geneva. ]



## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU I

Përveç kësaj, shtetet duhet të mbrojnë edhe privatësinë e informatave personale, shëndetësore dhe informatat e rehabilitimit të personave me handicap në baza të barabarta me të tjerët, neni 22 (2). Një dimension i rëndësishëm, në këtë kontekst, është mungesa e formave të komunikimit dhe procedurave dhe qasjes. Në këtë kontekst, KDPH në mënyrë eksplicite bën thirrje për heqjen e traditave, rregullave dhe praktikave të fituara dhe qëndrimeve nga ana e shtetit që çojnë në diskriminim mbi bazën e handicapit (neni 4 (1) (b) KDPH). Në përputhje me të drejtën për shëndet është edhe e drejta për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në komunitet (nenet 19, 25 (c) dhe 26 (1) (b) KDPH, OBSH, 2010a<sup>9</sup>). Siç thekson edhe Raportuesi Special se institucionet e shërbimit të bazuara në shërbime në komunitet janë “të përshtatshme për shëndetin, dinjitetin dhe përfshirjen” dhe, në fund

të fundit, përmes saj mund të shmanget institucionalizimi i panevojshëm (Raportuesit Special, 2005<sup>10</sup>). “Shërbimet duhet të përfshijnë ilaçe, fizioterapi, shërbime ambulatorë, programe për të maksimizuar pavarësinë dhe aftësitë e personave me handicap (nenet 9 (2) (e) dhe 24 (3) KDPH). Udhëzimet për mbrojtjen e së drejtës së cilësisë së OBSH-së theksojnë rëndësinë për mbylljen e objekteve të mëdha dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në bazë të KDPH (OBSH, 2012<sup>11</sup>).

Për të siguruar të drejtën e shëndetit dhe të drejtën e rehabilitimit, sidomos kur bëhet fjalë për abuzim, dhunë dhe shkelje të tjera të të drejtave të njeriut, duhet të merret në konsideratë neni 16 (4) KDPH: “Shtetet duhet të marrin masa për avancimin e reanimimit fizik, kognitiv dhe psikik, rehabilitimin dhe

<sup>9</sup>[WHO (2010a). Community-Based Rehabilitation: CBR-Guidelines Geneva (<http://www.who.int/disabilities/cbr/guidelines/en/>).]

<sup>10</sup>[Special Rapporteur (2005). On the right of everyone to the enjoyment of the highest attainable standard of mental and physical health, Paul Hunt, Report E/CN.4/2005/51.]

<sup>11</sup>[WHO (2012). Quality Rights ToolKit ([http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/70927/3/9789241548410\\_eng.pdf](http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/70927/3/9789241548410_eng.pdf))]

## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU I

ri-integrimin shoqëror të personave me handicap, të cilët kanë qenë viktima të ndonjë forme të eksploatimit, dhunës dhe abuzimit, duke përfshirë edhe përmes ofrimit të shërbimeve mbrojtëse. “Shërbimet që lidhen me rehabilitimin fizik dhe psikologjik, duke përfshirë edhe këshillimin rreth dhunës me bazë gjinore, nuk janë gjithmonë të arritshme, përfshirëse dhe të ndjeshme (Komenti i përgjithshëm numër 3 i Komitetit për të Drejtat e Personave me Handikap, paragrafi 57). Prandaj edhe neni 25 i KDPH-së i obligon shtetet që njerëzve me handicap t’u sigurohet e njëjta mbrojtje dhe program mbi shëndetin seksual dhe riprodhues, siç parashihen për personat e tjerë.

Neni 25 i KDPH përmban edhe detyrimin për miratimin e masave me të cilat do të ngritet edhe ndërgjegjja publike për çështjen e handicapit përmes trajnimeve dhe shpërndarjes së standardeve etike për mbrojtjen shëndetësore publike dhe private. Në kontekstin e ofrimit të kujdesit shëndetësor qasës dhe të mundshëm, të bazuar në mosdiskriminim, nga shtetet anëtare kër-

kohet t’i ndërmarrin të gjitha masat e duhura me qëllim që të sigurohet që individët, duke përfshirë edhe prindërit e ardhshëm, të marrin dhe japin informacione dhe ide në baza të barabarta me të tjerët (KDPH, neni 21). E drejta për informacion, në kontekstin e mbrojtjes shëndetësore, i referohet asaj që informacionet të jenë në dispozicion, të pranueshme (Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Koment i përgjithshëm 14) në përputhje me parimet e të drejtave të njeriut.

Për fund, neni 25 e ndalon diskriminimin ndaj personave me handicap në të siguruarit e sigurimit shëndetësor dhe jetësor, kur sigurimi i tillë lejohet sipas legjislacionit nacional dhe që duhet të sigurohet në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme (paragrafi 1, alineja e), si dhe parandalimin e pasigurisë diskriminuese të mbrojtjes shëndetësore ose shërbimeve shëndetësore ose ushqimit dhe lëngjeve bazuar në handicap të personit (paragrafi 1, f).



## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU I

## 2. Pikëpamje përfundimtare të Raportit Inicial të Republikës së Maqedonisë nga Komiteti mbi të Drejtat e Personave me Handikap

Në vitin 2018, në Sesionin e 20-të të OKB-së, në Komitetin për të Drejtat e Personave me handicap u vlerësua zbatimi i Konventës për të Drejtat e Personave me Handikap në Republikën e Maqedonisë. Në sesionin dyditor, u vlerësuan të drejtat civile dhe politike, si dhe të drejtat ekonomike dhe sociale për qytetarët me handicap, në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Handikap.

Në vëzhgimet përfundimtare të raportit fillestar të Republikës së Maqedonisë<sup>12</sup>, Komiteti për të Drejtat e Personave me Handikap vë në dukje disa rekomandime për realizimin e të drejtës për shëndetin (neni 25) i KDPH.

<sup>12</sup>[Shih: Vëzhgimet përfundimtare të Raportit inicial të Republikës së Maqedonisë nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Handikap, miratuar nga Komiteti në mbledhjen e tij të 20-të (27 gusht – 21 shtator 2018). OKB Komiteti për të Drejtat e Personave me Handikap. E gjeni në: < [https://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD/C/MKD/CO/1&Lang=En](https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD/C/MKD/CO/1&Lang=En)>]

## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU I

## Shëndetësia (neni 25)

Vërejtje	Rekomandime
<p>Komiteti është i shqetësuar se gjendja e handicapi në Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve nuk është baza për mbrojtjen nga diskriminimi dhe është i shqetësuar për mungesën e përgjithshme të qasjes në shërbimet e rregullta shëndetësore (paragrafi 41), posaçërisht:</p> <p>(a) Kufizimet në lidhje me moshën për qasjen deri te mbrojtja shëndetësore dhe trajtimi falas, së bashku me përjashtimet në Ligjin mbi shëndetësinë që diskriminon personat me handicap.</p> <p>(b) Mungesa e kornizave që garantojnë qasje të personave me handicap për të marrë pëlqimin e lirë dhe të informuar lidhur me shërbimet shëndetësore.</p>	<p>Komiteti (paragrafi 42) rekomandon që shteti-anëtar:</p> <p>(a) Të përfshijë handicapi si bazë për mbrojtjen nga diskriminimi në Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve;</p> <p>(b) të mënjanojë kufizimet e moshës për qasje në mbrojtjen shëndetësore dhe shërimin falas, si dhe të mënjanojë të gjitha përjashtimet në Ligjin për shëndetësi që diskriminon personat me handicap;</p> <p>(c) të miratojë një strategji për të siguruar qasje të lirë ose financiare për të gjitha shërbimet e nevojshme shëndetësore për personat me handicap, si dhe nëpërmjet trajnimit të punëtorëve shëndetësorë për të drejtat e personave me handicap, duke respektuar qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut për të drejtat e njeriut;</p>



**KAH PO LUNDRON KJO ANIJE**

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

**KAH PO LUNDRON KJO ANIJE**  
Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

**KREU I**

**KREU I**

(c) Mungesa e identifikimit të hershëm, disponueshmërisë dhe çmimeve të volitshme për shërbimet shëndetësore të specializuara që lidhen me handicap.

(ç) Mungesa e qasjes deri te produktet mjekësore esenciale të nevojshme për të mbajtur në mënyrë sa më të mirë të mundshme kushtet e jetesës.

(d) Mungesa e informacionit mbi shëndetin seksual dhe riprodhues në formate të qasshme për personat me handicap, duke përfshirë gratë dhe vajzat, si dhe mungesën e shërbimeve të specializuara për vajzat dhe gratë me handicap në të gjitha vendbanimet e shtetit - anëtar.

(dh) Qasje e dobët në shëndetësi dhe mungesa e shërbimeve të specializuara për fëmijët me handicap.

(ç) të miratojë protokolle shëndetësore me qëllim që të sigurohet e drejta e personave me handicap për të marrë pëlqimin e lirë dhe të informuar për trajtime mjekësore;

(d) të marrë masa për të siguruar identifikim të hershëm, disponueshmëri dhe qasjen e institucioneve dhe shërbimeve shëndetësore me heqjen e barrierave fizike në Qendrat shëndetësore dhe duke ofruar informacion në formate të arritshme;

(dh) të ofrojë informacione mbi të drejtat seksuale dhe riprodhuese në formate të përshtatshme për të gjithë personat me handicap, si dhe disponueshmërinë e shërbimeve gjinore dhe të moshës dhe të ofrojë shërbime të specializuara për personat me handicap në të gjitha vendbanimet e shtetit - anëtar;

e) të miratojë dhe zbatojë me shpejtësi një plan të ri veprimi për të përmirësuar kujdesin shëndetësor për fëmijët me handicap;

(ë) të promovojë disponueshmërinë e shërbimeve të specializuara shëndetësore në lidhje me handicap.

**Habitati dhe rehabilitimi (neni 26)**

**Vërejtje**

Komiteti është i shqetësuar për mungesën e legjislacionit përkatës në shtetin-anëtar për të siguruar që personat me handicap të kenë qasje në shërbimet e habilitimit dhe të rehabilitimit dhe se habilitimi dhe rehabilitimi nuk janë përcaktuar specifikisht brenda ligjeve dhe rregulloreve të shtetit - anëtar (paragrafi 43 ).

**Rekomandime**

Komiteti (paragrafi 44) rekomandon:  
  
Shteti - anëtar të miratojë legjislacionin e nevojshëm për të definuar dhe siguruar qasje në shërbimet e habilitimit dhe të rehabilitimit, me atë që do të sigurojë se të njëjtat bazohen në qasjen e të drejtave të njeriut dhe të zhvilluara me pjesëmarrjen e organizatave të personave me handicap.

**Të jetuarit e pavarur dhe përfshirja brenda komunitetit (neni 19)**

**Vërejtje**

Komiteti me shqetësim (paragrafi 31) vëren:  
(a) Procesin e dobët të deinstitutionalizimit dhe theksin e vendosur në riakomodimin e per-

**Rekomandime**

Lidhur me Komentin e përgjithshëm të Komisionit nr. 5 (2017) për jetesë të pavarur, Komiteti i rekomandon shtetit (paragrafi 32):

- (a) Të sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore, financiare



## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU I

KAH PO LUNDRON KJO ANIJE  
Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU I

sonave me handicap në shtëpitë e grupeve të vogla në vend të një mjedisi të përshtatshëm për jetesë të pavarur.

(b) Mungesën e shërbimeve dhe ofrimin i asistencës personale për të promovuar jetesën e pavarur të personave me handicap në vend;

(c) Faktin që shteti ende shpenzon më shumë mjete në institucione sesa në shërbimet e komunitetit.

(ç) Faktin se ekziston diskriminimi në bazë të moshës në pilot-programin për asistencë personale.

dhe teknike për implementimin e plotë të deinstitutionalizimit, veçanërisht për implementimin e tranzicionit në drejtim të kushteve të jetesës së pavarur;

- (b) Të ndajë burime të mjaftueshme për të siguruar asistencë personale dhe për të siguruar që shërbimet e komunitetit janë në dispozicion, të mundshme, me çmime të volitshme, të përshtatura dhe me cilësi të larta, në mënyrë që t'u mundësojnë personave me handicap të realizojnë dhe praktikojnë të drejtën e tyre për të jetuar të pavarur dhe të jenë të përfshirë në komunitet;
- (c) Të marrin masat e nevojshme për t'u siguruar se personat me handicap kanë të drejtë ligjore për buxhet të mjaftueshëm personal për jetesë të pavarur që merr parasysh kostot shtesë që kanë të bëjnë me gjendjen e handicapi dhe të caktojë resurset dhe mjetet nga institucionalizimi në drejtim të shërbimeve në komunitet;
- (ç) Të miratohen masa për sigurim të asistencës personale për personat me handicap pavarësisht moshës.

## Njohje të barabartë para ligjit (neni 12)

Vërejtje	Rekomandime
Komiteti është i shqetësuar se ligjet e shtetit, në veçanti sistemi ekzistues i kujdestarisë, privojnë ose kufizojnë aftësinë afariste të personave me handicap, duke kufizuar të drejtën e tyre për të vendosur dhe të drejtën për të zgjedhur (paragrafi 21).	Komiteti i rekomandon shtetit – anëtar (paragrafi 22): (a) Të shfuqizojë të gjitha dispozitat diskriminuese që lejojnë privimin aftësisë afariste në bazë të handicapi dhe të zhvillojë dhe zëvendësojë mekanizmat ekzistues me mekanizmat për mbështetje gjatë sjelljes së vendimeve që respektojnë autonominë, vullnetin dhe interesin e personit në fjalë; (b) Të realizojë aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve publikë për të drejtën e njohjes së barabartë përpara ligjit të personave me handicap dhe të drejtën për vendimmarrjen e mbështetur.

## Liria dhe mbrojtja e personit (neni 14)

Vërejtje	Rekomandime
Komiteti është i shqetësuar për dispozitat ligjore që mundësojnë privimin nga liria dhe trajtimi pa pëlqimin dhe mbajtjen e personave me handicap psikosociale në institucionet e shëndetit mendor.	Komiteti rekomandon që shteti - anëtar, në përputhje me udhëzimet për nenin 14, të shfuqizojë të gjitha dispozitat ligjore që parashohin privimin e pavullnetshme të lirisë në bazë të çrregullimit dhe trajtimit të pavullnetshëm të personave me handicap psikosociale dhe të zhvillojë shërbime të rehabilitimit në komunitet me qëllim të rimëkëmbjes së këtyre personave.



**KAH PO LUNDRON KJO ANIJE**

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

**KREU I**

**KAH PO LUNDRON KJO ANIJE**  
Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

**KREU I**

**Liria nga eksploatimi, dhuna dhe abuzimi (neni 16)**

**Të respektuarit e shtëpisë dhe familjes (neni 23)**

Vërejtje	Rekomandime
<p>Komiteti është i shqetësuar se Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna familjare është i paqartë në lidhje me ndalesën për eksploatim, dhunë dhe abuzim të personave me handicap.</p> <p>Për më tepër, strehimoret për viktimat e dhunës familjare, duke përfshirë shërbimet e tyre, nuk janë të qasshme për personat me handicap.</p>	<p>Komiteti rekomandon shteti-anëtar të marrë masa për:</p> <p>(a) Rishikimin e legjislacionit dhe politikave ekzistuese me qëllim të inkorporimit të mjeteve dhe sanksioneve juridike që parandalojnë të gjitha format e dhunës, abuzimit dhe keqtrajtimit në sferat publike dhe private kundër personave me handicap, veçanërisht grave, vajzave dhe fëmijëve me handicap psikosociale dhe/ose fëmijëve me handicap intelektuale;</p> <p>(b) Trajnimin e stafit dhe punonjësve në strehimore për qasjen ndaj handicapi të bazuar në të drejtat e njeriut;</p> <p>(c) Të sigurojë që strehimoret për viktimat e dhunës dhe shërbimet e tyre janë të qasshme për personat me handicap;</p> <p>(ç) Kryerjen e hetimit për të gjitha pretendimet e dhunës dhe abuzimit të personave me handicap, veçanërisht ato me handicap psikosociale dhe/ose handicap intelektuale, si dhe arsye të dyshimta për vdekjen e shfrytëzuesve në institucione.</p>

Vërejtje	Rekomandime
<p>Komiteti është i shqetësuar për dispozitat ligjore në Ligjin për familjen që diskriminon personat me handicap psikosociale dhe/ose personat me handicap intelektuale për t’u martuar dhe për të krijuar familje. Për më tepër, Komiteti është i shqetësuar për dispozitat në ligjin e lartpërmendur, i cili kërkon që personi me handicap intelektuale dhe/ose personi me handicap psikosociale të certifikohet si “person me njohuri dhe mirëkuptim”.</p>	<p>Komiteti rekomandon shteti-anëtar të marrë masa për:</p> <p>a) Të shqyrtuar Ligjin mbi familjen që të sigurojë që personat me handicap të mund të praktikojnë marrëdhëniet e tyre në baza të barabarta me të tjerët dhe në bazë të pëlqimit të tyre të lirë dhe të informuar;</p> <p>b) Miratimin e masave për promovimin e mbrojtjes dhe trajnimit të duhur ligjor të punonjësve gjyqësorë dhe socialë për të siguruar që personat me handicap të mos diskriminohen gjatë procedurave ligjore dhe administrative në lidhje me të drejtat e tyre seksuale dhe riprodhuese, të drejtën për të formuar familje dhe kujdestari mbi fëmijët e tyre.</p>

# KREU II

## KORNIZA

### LIGJORE NACIONALE



**KAH PO LUNDRON KJO ANIJE**  
Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap  
në Republikën e Maqedonisë me vështirësi mbi të  
drejtën në mbrojtjen shëndetësore

## KREU II

### 1. Legjislacioni nacional dhe harmonizimi i tij me KDPH

E drejta për mbrojtje shëndetësore është rregulluar me nenin 39 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë<sup>13</sup>. Nëse këtë nen e vëmë në korrelacion me ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit, neni 9 i Kushtetutës ku aftësia e kufizuar nuk është dhënë si bazë e mundshme për diskriminim, ushtrimi i të drejtës për kujdes shëndetësor bëhet i diskutueshëm.

Nga aspekti i parimit të përgjithshëm të respektimit të të drejtave të njeriut, Ligji për mbrojtjen shëndetësore (në tekstin e mëtejshëm: LMSH)<sup>14</sup> rregullon të drejtën e çdo qytetari (neni 3 paragrafi 1) në nivelin më të lartë të mundshëm të mbrojtjes shëndetësore. Parimet në të cilat bazohet LMSH-ja nuk janë të përpunuara tërësisht në kuptimin e zbatueshmërisë

së tyre dhe nuk japin udhëzime për funksionalizimin e tyre në nivele të ndryshme të mbrojtjes shëndetësore nga aspekti i qytetarëve me handicap.

Ligji për sigurimin shëndetësor (në tekstin e mëtejshëm: LSSH)<sup>15</sup> u ofron qytetarëve shërbime shëndetësore në kujdesin parësor, specialistik-konsultativ dhe spitalor (afatshkurtër dhe afatgjatë) dhe shërbime shëndetësore përmes programeve qeveritare për kujdesin shëndetësor parandalues dhe kurativ.

Gjatë përdorimit të shërbimeve shëndetësore dhe ilaçeve, personat e siguruar marrin pjesë me fonde personale, por deri në 20% të shumës mesatare të shpenzimeve totale të shërbimit shëndetësor, përkatësisht ilaçeve (neni 32). Përveç pakove bazë të mbrojtjes shëndetësore, mbrojtja terciare shëndetësore nuk përfshin personat me handicap<sup>16</sup>. Klinikat gjinekologjike dhe spitalet e

<sup>13</sup>[Kushtetuta e R. Maqedonisë në: <<http://www.sobranie.mk/ustav-na-rm.nspk>>.]

<sup>14</sup>[Ligji për mbrojtje shëndetësore. Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/2012, 145/2012, 87/2013, 164/2013, MSH. E gjeni në: <[http://mz.gov.mk/wp-content/uploads/2012/12/zakon-za-zdravstvena-zastita-2\\_12\\_2012.pdf](http://mz.gov.mk/wp-content/uploads/2012/12/zakon-za-zdravstvena-zastita-2_12_2012.pdf)>]

<sup>15</sup>[Ligji për sigurim shëndetësor (Teksti integral i konsoliduar Gazeta Zyrtare nr. 65/2012, 16/2013 dhe 91/2013), Fondi për sigurim shëndetësor. E gjeni në: <[http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Zakon%20za%20zdravstveno%20oisguruvanje%20\(Interen%20precisten%20tekst\).pdf](http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Zakon%20za%20zdravstveno%20oisguruvanje%20(Interen%20precisten%20tekst).pdf)>]



## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

## KREU II

lindjes nuk janë në dispozicion për gratë me handicap, nuk kanë staf të trajnuar, as pajisje (pa karrige për gratë me handicap) dhe pa informata, veçanërisht në qytetet më të vogla në vend. Spitalët, përveç që janë pa akses, nuk ofrojnë mbështetje për nënat me handicap.

Një nga arsyet për përdorimin joefikas dhe joefektiv të shërbimeve shëndetësore është qasja e pamundshme fizike e institucioneve shëndetësore, duke përfshirë vetë MSH-në dhe FSSH-në<sup>17</sup>. Për sa i përket ushtrimit të së drejtës për sigurim shëndetësor, personat me handicap shpesh nuk vizitojnë mjekun, sepse nuk janë në gjendje të paguajnë participimin dhe/ose shërbimin e plotë.

Në bazat për mbrojtje nga diskriminimi, në Ligjin për mbrojtjen e pacientëve (në tekstin e mëtejme: LMP)<sup>18</sup> nuk janë të përfshirë personat me handicap, si bazë e posaçme. LMP parasheh edhe të drejtën e informacionit për pacientin me aftësi të dobët të përhershme për vendosje<sup>19</sup> por, për shkak të mungesës së trajnimeve për komunikim dhe qasje ndaj njerëzve me handicap, në praktikë kjo e drejtë është e vështirësuar. Ndërsa e drejta për të zgjedhur në praktikë nuk zbatohet<sup>20</sup>.

Në diapozitivin për mosdiskriminim, në Ligjin për shëndet mendor<sup>21</sup> “personat me sëmundje mendore kanë të drejtën e mbrojtjes nga çdo formë e ngacmimit, përcmimit dhe abuzimit dhe nuk duhet

të diskriminohen për shkak të gjendjes së shëndetit të tyre mendor”. Pavarësisht nga korniza e vendosur ligjore në mënyrë solide, praktika e qasjes ndaj njerëzve me handicap intelektuale dhe trajtimi i tyre në institucione tregon një pamje tjetër<sup>22</sup>. Të njëjta janë rezultatet dhe konstatimet për gjendjen e personave të vendosur në institucione të posaçme dhe spitale psikiatrike<sup>23</sup>. Konkluzioni i përgjithshëm është se gjendja e shëndetit mendor në Republikën e Maqedonisë karakterizohet me mbrojtje institucionale dhe protektive të modës shumë të vjetër, me kapacitete të papërshtatshme akomodimi dhe modele të papërshtatshme për rehabilitim mjekësor<sup>24</sup>.

## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

## KREU II

Në bazat për mbrojtje nga diskriminimi, në Ligjin për shëndetin publik<sup>25</sup>, aftësia e kufizuar nuk është e përfshirë. Çështja e handicapi nuk është pjesë e kriterëve gjatë përgatitjes dhe ofrimit të programeve për përsosmëri profesionale në fushën e shëndetit publik. Në pajtim me ligjin për ilaçe dhe pajisje mjekësore për asistencë<sup>26</sup> në kriteret për lëshimin ilaçit dhe pajisjes në treg nuk janë paraparë standardet e qasjes dhe disponueshmërisë.

Dispozitat ekzistuese ligjore pengojnë personat me handicap të marrin pajisje ndihmëse të përshtatshme për mobilitet ose shërbime. Fija bazë përmes së cilës sigurohen shërbimet shëndetësore është

<sup>21</sup>[Ligji për shëndet mendor, Gazeta Zyrtare e RM nr. 71 2006. Në dispozicion: < <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/3549F74997B0084E9C47AC8F8A7423BC.pdf>>]

<sup>22</sup>[Shih: Raport nga ekspertiza e realizuar në Organizatën Publike shëndetësore Spitali psikiatrik “Shkup” – Shkup, Departamenti për mbrojtje jashtë spitalore dhe avancim të shëndetit mendor “Prolet” – Shkup dhe Spitali psikiatrik “Demir Hisar” 2006, faqe 2. E gjeni në: < <http://ombudsman.mk/upload/documents/JZO-mak.pdf>>]

<sup>23</sup>[Shih: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut – Raporti i vizitës së institucioneve speciale dhe spitaleve psikiatrike në R. Maqedonisë për 2011 dhe 2012. Në dispozicion në: < <http://www.mhc.org.mk>>]

<sup>24</sup>[Shih: Instituti për shëndet publik të R. Maqedonisë – Raporti për shëndetin e banorëve në RM 2013, faqe 123. E gjeni në: < <http://prizma.bim.eu.com>>]

<sup>25</sup>[Ligji për shëndet publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 136/2011 <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2012/12/zakon-za-javno-zdravje-precisten.pdf>]

<sup>26</sup>[Ligji për ilaçet dhe pajisjet mjekësore ndihmëse, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 11/2012 <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2012/12/zakon-za-lekovi-i-medicinski-pomagala.pdf>]

<sup>16</sup>[Shih: Hendiket – mozaik që mungon – Pasqyra e gjendjes së personave me handicap, 2012 Polio Plus – lëvizja kundër aftësive të kufizuara, faqe 60- 64, [www.polioplus.org.mk](http://www.polioplus.org.mk).]

<sup>17</sup>[Shih: “Shëndeti seksual dhe reprodaktiv dhe personat me handicap fizike – Raport nga vlerësimi për nevojat e shërbimeve – Hera, faqe 20,2012, <[http://hera.org.mk/wp-content/uploads/2014/02/izvestaj\\_poprecenost\\_rz.pdf](http://hera.org.mk/wp-content/uploads/2014/02/izvestaj_poprecenost_rz.pdf)>. Në dispozicion më: 21.10.2014, ]

<sup>18</sup>[Shih: Ligj për mbrojtje të të drejtave të pacientëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82 e datës 08.07.2008). E gjeni në: <<http://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakonet-za-zashtita-na-pravata-na-patsientite-02-07-2008.pdf>>]

<sup>19</sup>[Shih: “Të drejtat e pacientëve me fokus të personave me handicap intelektuale” ESE, 2011, faqe 6. <http://www.esem.org.mk/pdf/Publikacii/ESE%20Intelektualna%20poprecenost.pdf>]

<sup>20</sup>[Shih: Handikap – mozaiku që mungon – Pasqyra e gjendjes së personave me handicap, 2012, Polio Plus – lëvizja kundër handicap. E gjeni në: <[www.polioplus.org.mk](http://www.polioplus.org.mk)>]



## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handikap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

---

# KREU II

mosha dhe shkalla e handikapi, që përbën një praktikë serioze diskriminuese. Për shkak të kufirit të moshës dhe trajtimit të personave me handikap deri në moshën 26 vjeçare si fëmijë, qytetarët me handikap përballen me qasje të kufizuar në sigurimin e kujdesit shëndetësor, rehabilitimit, pajisjeve ndihmëse dhe ilaçeve falas.

Edhe për sigurimin e një karroce elektromotorike, shteti bën diskriminim të drejtpërdrejtë. Në Rregullore theksohet: “Personat e siguruar me aftësi të përhershme të kufizuar nga mosha 7-26 vjeç e mbi 65 vjeç kanë të drejtë të përdorin karroca elektrike – skuter motor elektrik”. Me këtë dispozitë, personat me handikap midis 26 dhe 65 vjeç nuk plotësojnë kushtet për një karrocë me motor elektrik - skuter. Përveç kësaj, kostoja për pjesëmarrje për këpucë ortopedike nuk është e disponueshme për personat me handikap.

Përveç gëzimit të së drejtës për rehabilitim, personat me handikap janë në pozitë të papërshtatshme, me pamundësinë për të gëzuar të drejtën për rehabilitim periodik në kushte të banjave klimatike, por

vetëm si një trajtim traumatologjik dhe postoperativ i vazhdueshëm për një periudhë kohore të kufizuar.

Përveç shërbimeve të theksuara shëndetësore, megjithatë, mungojnë shërbime të specializuara shëndetësore, programe dhe shërbime për parandalim, zbulim të hershëm, diagnostikim, trajtim të hershëm dhe rehabilitim i fëmijëve dhe të rriturve me handikap. Punëtorët shëndetësor dhe pacientët nuk i njohin në masë të mjaftueshme të drejtat dhe detyrimet e pacientëve, si dhe të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve shëndetësor. Kjo situatë kontribuon në rritjen e rasteve të shkeljes së tyre, si dhe në ekzistimin e mosbesimit mes pacientit dhe mjekut në marrjen e vendimeve dhe sigurimin e shërbimeve shëndetësore.

# KREU III

## DEMISTIFIKIMI I ÇËSHTJES E HANDIKAPIT NË REALIZIMIN E TË DREJTËS MBROJTJES SOCIALE



**KAH PO LUNDRON KJO ANIJE**  
Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap  
në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të  
drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU III

### 1 Objektiv, lënda dhe shembulli i hulumtimit

Analiza – “Kah po lundron kjo anije” - është përpiluar në kuadër të projektit “Margina Obscura - çështja e handicap në procesin e pranimit në BE” të cilën e realizon Polio Plus - lëvizja kundër handicap. Qëllimi i analizës ishte që të zbardhet çështja e handicap në praktikë ose për të pasqyruar gjendjen aktuale në drejtim të realizimit të të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar në fushën e të drejtës për mbrojtje sociale.


Numri i përgjithshëm i të anketuarve/ anketuarave është 1000 persona, prej të cilëve 500 janë persona me handicap dhe 500 janë prindër të fëmijëve me handicap, duke pasur parasysh të gjitha llojet e aftësive të kufizuara. Ekzemplari i tërësishëm është stratifikuar sipas llojit të handicapi, gjinisë, përkatësisë etnike, moshës, shkallës së arsimit dhe vendit të banimit/komunave.

Në këtë aspekt, ekzemplari i hulumtimit për personat me handicap ndahet

si më poshtë: 185 persona me handicap fizike (37%), 145 persona me shikim të dëmtuar (29%), 140 persona me dëgjim të dëmtuar (28%) dhe 30 persona me handicap intelektuale (6%). Nga prindërit e fëmijëve me handicap, përgjigje janë kthyer nga 120 prindër të fëmijëve me handicap fizike (24%), 35 prindër të fëmijëve me shikim të dëmtuar (7%), 60 prindër të fëmijëve me dëgjim të dëmtuar (12%), 105 prindër të fëmijëve me handicap të kombinuara (21%) dhe 180 përgjigje nga prindërit e fëmijëve me handicap intelektuale (36%) (shih Grafikon numër 1).

Ekzemplari hulumtues sipas gjinisë në tërësi ndahet në 520 të anketuar të gjinisë femërore, gjegjësisht 52%, dhe 480 të anketuar të gjinisë mashkullore, gjegjësisht 48%. Grafiku numër 2 jep pasqyrë kumulative të ekzemplarit sipas gjinisë së kryqëzuar me llojin e handicapi. Përkatësisht, prej 265 janë femra të anketuara me handicap, kundrejt 235 që janë meshkuj me handicap, ndërsa 255 prej prindërve janë gra kundrejt 245 që janë burra.






## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE


Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU III

**Grafiku 1.** Shembull nga terreni – persona me handicap, mbi bazën e handicapit



**Grafiku 2.** Shembull nga terreni – persona me handicap dhe prindër të fëmijëve me handicap



## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore


# KREU III

**Tabela 1.** Shembull nga terreni – persona me handicapi dhe prindër të fëmijëve me handicap sipas përfaqësimit etnik

Përkatësia etnike	Persona me handicap fizike	Persona me shikim të dëmtuar	Persona me dëgjim të dëmtuar dhe pengesa në të folur	Persona me handicap të kombinuar	Persona me handicap intelektuale	Prindër të fëmijëve me handicap fizike	Prindër të fëmijëve me shikim të dëmtuar	Prindër të fëmijëve me dëgjim të dëmtuar dhe pengesa në të folur	Prindër të fëmijëve me handicap të kombinuar	Prindër të fëmijëve me handicap intelektuale
Maqedonas	110	80	100		25	80	20	50	70	110
Shqiptarë	75	45	20		5	25	10		30	60
Boshnjakë		5	10			5			5	
Turq		10	5			10	5			
Vlleh			5							5
Romë		5						10		5

Shikuar nga aspekti i mbulimit territorial, në kuadër të këtij hulumtimi janë përfshirë si zonat urbane ashtu edhe ato rurale. Përfaqësim më të madh ka në Shkup, ku janë përfshirë 200 anketues, më pas Tetova me 165 anketues, e më pas vijoje nga Velesi me 80 anketues, Prilepi – 75 anketues, Gostivari -70, Gjevgjelia – 35 anketues, Strumica, Struga, Radovishi, Ohri, Negotina, Dojrani dhe Vinica – 15 anketues, Gradsko – 30 anketues, Resnja – 25, Probishtipi, Shtipi, Kërçova, Kriva Pallanka dhe Bogovinja me nga 20 anketues, Koçani, Kratova, Kumanova, me nga 10 anketues, Manastiri, Bërvenica, Debarca me nga 5 anketues

Në Grafikon numër 3 është dhënë një pasqyrë kumulative e ekzemplarit sipas moshës, e ndarë në tetë grupe të moshave. Prej saj mund të konkludohet se shumica e të anketuarve/anketuarave janë persona me handicap ose prindër të fëmijëve me handicap që i përkasin grupmoshës mbi 30 vjet, me një përqindje totale prej 85%, ndërsa së paku të grupmoshës deri në 30 vjet me një përqindje totale 15%. Numri më i madh i të anketuarve/anketuarave me handicap janë nga grupmoshat prej 30 deri 34 vjeç dhe prej 40 deri 44 vjeç, duke përbërë 37% të nën-ekzemplarit hulumtues të personave me handicap. Nga ana tjetër, numri më i madh i prindërve të intervistuar të fëmijëve me




## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirësi mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU III

**Grafiku 3.** Shembull nga terreni – persona me handicap dhe prindër të fëmijëve me handicap në bazë të grupmoshave



handikap janë nga grupmoshat prej 35 deri 39 vjeç dhe 50+ vjeç, që përbëjnë 51% të nën-ekzemplarit hulumtues të prindërve të fëmijëve me handicap.

Në Grafikonin numër 4 është dhënë pasqyra e nivelit të arsimit të ekzemplarit hulumtues nga i cili ne mund të vijmë në


konkluzion se shumica e të anketuarve/ anketuarave, dhe atë një numër i konsiderueshëm, kanë përfunduar arsimin e mesëm me 98% përqindje kumulative (47% të personave me handicap dhe 51% e prindërve të fëmijëve me handicap), të ndjekur nga grupi i të anketuarve/an-

## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirësi mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU III

**Grafiku 4.** Shembull nga terreni – persona me handicap dhe prindër të fëmijëve me handicap në bazë të arsimit



ketuarave me arsimin fillor të mbaruar me 43% përqindje kumulative (27% të personave me handicap dhe 16% e prindërve të fëmijëve me handicap) dhe me arsimin e lartë 41% përqindje kumulative (vetëm 8% e personave me handicap dhe 33% e prindërve të fëmijëve

me handicap). Shqetësues është fakti që 18% e të anketuarve/ anketuarave me handicap janë pa arsim formal



## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU III

## 2. Analiza kuantitative dhe kualitative e përgjigjeve të pyetësorëve

Nga pyetësi grumbullohen të dhënat mbi përvojat e personave me handicap dhe prindërve të fëmijëve me handicap për ushtrimin e të drejtës për barazi dhe mosdiskriminim në mbrojtje shëndetësore. Përkatesisht, në Grafikon nr. 5 është shfaqur pasqyrë e ekzemplarit sipas vlerësimit nëse të anketuarit/at mendojnë se personat me handicap janë të barabartë me qytetarët e tjerë (Grafiku nr. 5).

Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve/anketuarave persona me handicap të gjithë në numër absolut konsiderojnë se nuk janë të barabartë, ndërsa 99% e prindërve të fëmijëve me handicap konsiderojnë se fëmijët e tyre nuk janë të barabartë me fëmijët e tjerë, që nuk kanë handicap.

Në pyetjen se në cilën sferë të jetës shoqërore personat me handicap janë më së shpeshti të diskriminuar, ekzemplari i përgjithshëm i hulumtimit konsideron se ajo është sfera e mbrojtjes sociale për të cilën 96% e të anketuarve konsiderojnë se është më e shpeshta dhe shëndetësia me 94%. Pastaj vijon sfera e arsimit,

shkencës dhe sportit me 70.5%, puna dhe marrëdhëniet e punës me 64.5% dhe qasja deri te mjetet dhe shërbimet me 62%. Në sferën e informimit publik dhe medias, 46% e të anketuarve/ anketuarave konsiderojnë se është e shpeshtë, pastaj sfera e gjyqësorit dhe administratës me 39%, dhe strehimit me 27%. Së fundi, është sfera e kulturës me 5.7% e të anketuarve/ anketuarave që konsiderojnë se është e shpeshtë dhe anëtarësimi dhe aktiviteti në organizatat sindikaliste, partitë politike, shoqatat dhe fondacionet ose organizatat e tjera të bazuara në anëtarësim me 2.5% (Grafiku numër 6).

Në sferën e mbrojtjes shëndetësore, prej 94% të të anketuarve që konsiderojnë se janë të diskriminuar, 44% janë të anketuarit/at me handicap, ndërsa 50% janë prindër të fëmijëve me handicap. Nga numri i përgjithshëm i personave me handicap, 18% janë persona me handicap fizike, pastaj vijnë personat me shikim të dëmtuar 13%, personat me dëgjim të dëmtuar dhe pengesa në të folur me 12%, ndërsa 1% janë deklaruar persona me handicap intelektuale. Sikurse edhe tek personat me handicap, e ngjashme është pikëpamja edhe e prindërve të fëmijëve me handicap.


KAH PO LUNDRON KJO ANIJE  
Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU III

Gjegjësisht, 50% e opinionit të grumbulluar, 18% e prindërve të fëmijëve me handicap intelektuale konsiderojnë se personat me handicap janë të diskriminuar në shëndetësi. 12% e prindërve të fëmijëve me handicap fizike, 10.5% e prindërve të fëmijëve me handicap të

kombinuara, 6% e prindërve të fëmijëve me dëgjim të dëmtuar dhe pengesa në të folur, të cilët konsiderojnë se personat me handicap më së shpeshti diskriminohen në shëndetësi (Tabela numër 2).

Grafiku 5. Nëse personat me handicap janë të barabartë me qytetarët e tjerë?





## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU III

Në pyetjen nëse personat me handicap janë të mbrojtur nga diskriminimi gjatë ofrimit të mbrojtjes shëndetësore, në mënyrë kumulative (94.5%) e të anketuarve/ anketuarave konsiderojnë se personat me handicap nuk janë të mbrojtur nga diskriminimi. Ndërsa 5.5% kanë deklaruar se nuk e dinë. Përkundër faktit se pikëpamjet edhe të prindërve edhe të personave me handicap janë

identike, megjithatë 48% e prindërve janë përgjigjur negativisht në lidhje me personat me handicap të cilët për 2.5% janë deklaruar më pak. Sa i përket përgjigjeve me “nuk e di”, e njëjta gjë dominon tek personat me handicap, të cilët për 1,5% janë deklaruar më shumë ne relacion me prindërit e fëmijëve me handicap. (Grafiku numër 7).


**Tabela 2.** Sipas Juve, në cilën sferë të jetës shoqërore personat me handicap janë më shpesh të diskriminuar?

Në cilën sferë të jetës shoqërore personat me handicap janë më shpesh të diskriminuar?	Persona me handicap fizike	Persona me shikim të dëmtuar	Persona me dëgjim të dëmtuar dhe të foluar	Persona me handicap intelektuale	Prindër të fëmijëve mehandikap fizike	Prindër të fëmijëve me shikim të dëmtuar	Prindër të fëmijëve me dëgjim të dëmtuar	Prindër të fëmijëve me handicap të kombinuara	Prindër të fëmijëve mehandikap intelektuale
Punë dhe marrëdhënie e punës	17,5%	9,0%	12,5%	3,0%	6,0%	1,5%	4,5%	3,0%	7,5%
Arsim, shkencë dhe sport	15,0%	10,5%	11,0%	1,0%	10,0%	2,5%	5,5%	3,5%	11,5%
Mbrojtje sociale	18,0%	13,5%	11,5%	3,0%	12,0%	3,5%	6,0%	10,5%	18,0%
Mbrojtje shëndetësore	18,0%	13,0%	12,0%	1,0%	12,0%	3,5%	6,0%	10,5%	18,0%
Gjyqësor dhe administratë	14,5%	5,0%	7,0%	0,5%	5,0%	0,5%	2,0%	1,0%	3,5%
Banim	5,0%	2,0%	5,0%	0,0%	7,0%	0,5%	2,0%	1,5%	4,0%
Informim publik dhe medime	4,0%	8,0%	14,0%	0,5%	4,5%	2,0%	3,5%	2,5%	7,0%
Qasje në të mira dhe shërbime	13,0%	6,5%	13,5%	1,5%	11,0%	2,5%	6,0%	2,5%	5,5%
Anëtarësim në organizata sindikaliste, parti politike, shoqata dhe fondacione apo organizata tjera që bazohen në anëtarësim	1,0%	0,5%	0,5%	0,5%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Kulturë	1,5%	1,0%	2,0%	1,0%	0,0%	0,0%	0,2%	0,0%	0,0%


KAH PO LUNDRON KJO ANIJE  
Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore


# KREU III

**Grafiku 6.** Në cilën sferë të jetës shoqërore personat me handicap janë më shpesh të diskriminuar?



**Grafiku 7.** Nëse personat me handicap janë të mbrojtur nga diskriminimi gjatë ofrimit të mbrojtjes shëndetësore?






## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE


Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU III

**Grafiku 8.** Nëse personat me handicap janë të mbrojtur nga diskriminimi gjatë ofrimit të mbrojtjes shëndetësore?



**Grafiku 9.** Sipas Juve, nëse institucionet shëndetësore janë të qasshme dhe të arritshme për personat me handicap?



## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU III

Nga Grafiku numër 8 mund të vërehet se nuk ka devijime të mëdha në mesin e të anketuarve në bazë të llojit të handicapi. Sa i përket përgjigjeve “Nuk e di” në relacion me personat me handicap, prindërit e fëmijëve me handicap fizike u përgjigjën 0.5%. 1% e personave me shikim të dëmtuar dhe 1% e prindërve të fëmijëve me shikim të dëmtuar u përgjigjën “nuk e di”. E ngjashme është pikëpamja edhe tek personat me dëgjim të dëmtuar dhe pengesa në të folur dhe prindërit e fëmijëve me dëgjim të dëmtuar dhe pengesa në të folur.

Në realizimin e të drejtave të qytetarëve me handicap, një nga çështjet kryesore është qasja dhe aksesimi. Në pyetjen nga Grafiku numër 9, nëse institucionet shëndetësore janë të qasshme dhe të arritshme për personat me handicap, në mënyrë kumulative të gjithë të anketuarit me 82.5% janë deklaruar se institucionet nuk janë të qasshme, ndërsa 17.5% janë përgjigjur se ato janë pjesërisht të qasshme.


Ky mendim është i ngjashëm edhe tek të anketuarit me handicap edhe tek prindërit e fëmijëve me handicap. Gjegjësisht, 43.5% e personave me

handikap janë decid që organet e institucioneve shëndetësore nuk janë të qasshme, ndërsa 6.5% e tyre konsiderojnë se institucionet janë pjesërisht të qasshme. 11% e prindërve të fëmijëve me handicap konsiderojnë se institucionet janë pjesërisht të qasshme, ndërsa vetëm 39% e tyre konsiderojnë se institucionet shëndetësore nuk janë aspak të qasshme.

Ekzistojnë variacione të caktuara në bazë të llojit të handicapi tek vetë të anketuarit. Nga Grafiku numër 10 mund të shihet se personat me handicap janë më kategorik në lidhje me deklarin për paakseshmërinë e institucioneve shëndetësore.

Ekzistojnë variacione të caktuara tek personat me shikim të dëmtuar dhe tek personat me dëgjim të dëmtuar dhe pengesa në të folur, të cilët me nga 2.5% janë deklaruar se institucionet janë pjesërisht të qasshme dhe 1.5% tek personat me handicap intelektuale.

Vlerësimi i institucioneve se janë pjesërisht të qasshme është më i theksuar në mesin e prindërve të fëmijëve me handicap. Edhe këtu në bazë të llo-




## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU III

**Grafiku 10.** Sipas Juve, nëse institucionet shëndetësore janë të qasshme dhe të arritshme për personat me handicap?



jit të aftësive të kufizuara ekzistojnë variacione, ku vlerësimi më i lartë është i prindërve të fëmijëve me handicap intelektuale 4.5%, dhe pastaj vijon ai i prindërve të fëmijëve me dëgjim të dëmtuar dhe pengesa në të folur me 3.5% dhe prindërit e fëmijëve me shikim të dëmtuar me 2.5%. Ky vlerësim

është më i ulët në mesin e prindërve të fëmijëve me shikim të dëmtuar me 1.5%, prindërit e fëmijëve me handicap fizike e dhanë vlerësim 1% dhe prindërit e fëmijëve me handicap të kombinuara me 0.5% të cilët u deklaruan se institucionet janë pjesërisht të qasshme.

## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore


# KREU III


Ky lloj i të menduarit dhe deklaratat e pjesëmarrësve të fokus grupeve tregojnë se institucionet nuk janë të qasshme për personat me handicap. Po ashtu në sigurimin e dokumentacioneve të nevojshme nga mbrojtja shëndetësore, njerëzit me handicap kanë theksuar se atë më shpesh për ata e bëjnë prindërit e tyre ose të afërmit të tyre. Ky është edhe një tregues tjetër që personat me

handikap janë në gjendje krejtësisht të pafavorshme dhe janë plotësisht të varur nga të afërmit e tyre për të realizuar të drejtat e tyre.

Pakënaqësia nga ana e të anketuarve në lidhje me qasshmërinë reflektohet edhe në mendimin e tyre dhe në punën e punonjësve shëndetësor në institucionet shëndetësore. 99% e të anketuarve kanë vlerësuar negativisht punën e

**Grafiku 11.** Si e vlerësoni punën e punonjësve të shëndetit sa u përket personave me handicap?






## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU III

punëtorëve shëndetësor në raport me qytetarët me handicap. Nga Grafiku numër 11 mund të shihet se 41% e të anketuarve në mënyrë kumulative janë shprehur se puna e punëtorëve shëndetësorë nuk është e mirë, 34.5% janë përgjigjur se nuk e pëlqejnë, ndërsa 23.5% konsiderojnë se është ajo që nevojitet. Vetëm 0.5% u përgjigjën pozitivisht dhe e njëjta përqindje janë shprehur se nuk e dinë.

**Grafiku 12.** Ekzemplar hulumtimi sipas të anketuarve që janë përgjigjur në pyetjen: Si e vlerësoni punën e institucioneve të shëndetit sa u përket personave me handicap?



## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU III

Kjo pikëpamje në mesin e të anketuarve ndryshon në thelb nëse bëhet fjalë për personat me handicap ose për prindërit e fëmijëve me handicap. Përkatesisht, në Grafikon numër 12 mund të shihet se personat me handicap janë më kategorik sa i përket vlerësimit negativ të punës së punonjësve të shëndetit për dallim nga prindërit.

Nga 99% e të anketuarve që janë përgjigjur negativisht, 49% i përkasin personave me handicap. Prej tyre, 21% janë deklaruar kategorikisht se puna e institucioneve shëndetësore nuk është e mirë kundrejt prindërve, ku mendimi i tyre është 6.5% më i ulët. E ngjashme është pikëpamja e përgjigjeve “nuk i pëlqen”, ku këtë pikëpamje e ndajnë 19% e personave me handicap, ndërsa prindërit janë përgjigjur 20%. Gjithsej 9% e personave me handicap mendojnë se nuk është ajo që nevojitet.

Mendimi i këtyllë reflektohet edhe tek vet të anketuarit me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara. Personat me handicap fizike janë më kategorik sa i përket vlerësimit të punës së punonjësve të shëndetit se nuk është mirë, për dallim nga prindërit e fëmijëve me handicap fizike, ku mendimi i tyre është 4% më i ulët. Te personat me dëgjim të dëmtuar

dhe pengesa në të folur është më e theksuar përgjigja se ata “nuk e pëlqejnë punën e institucioneve shëndetësore” me 7.5% në raport me personat me handicap fizike dhe personat me shikim të dëmtuar, ku pikëpamja e tyre është 2% më e ulët. (Grafiku numër 13).

Sipas përgjigjeve për aksesin, të anketuarit me 94% besojnë se procedurat për marrjen e mbrojtjes shëndetësore primare, sekondare dhe terciare për personat me handicap nuk janë të qasshme dhe lehtësisht të arritshme. Siç mund të shihet nga Grafiku 14, 50% e prindërve të fëmijëve me handicap konsiderojnë se procedurat nuk janë të qasshme dhe lehtësisht të arritshme, krahasuar me 44% të personave me handicap.

Ndryshe nga prindërit, vetëm 6% e personave me handicap janë përgjigjur se nuk e dinë nëse procedurat janë të arritshme apo jo. Nga Grafiku 15 mund të vërehet se ky mendim është më i theksuar tek personat me dëgjim të dëmtuar dhe pengesa në të folur, ku 3% e tyre janë shprehur se procedura është e qasshme dhe të lehtë e arritshme. 1% e personave me handicap fizike, 1.5% e personave me shikim të dëmtuar dhe 0.5% e personave me handicap intelektual janë përgjigjur se nuk e dinë. Kjo




**KAH PO LUNDRON KJO ANIJE**


Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

**KREU III**

**Grafiku 13.** Si e vlerësoni punën e institucioneve të shëndetit sa u përket personave me handicap?



**Grafiku 14.** Nëse procedura për mbrojtjen shëndetësore primare, sekondare dhe terciare për personat me handicap është e qasshme dhe lehtë e arritshme?




**KAH PO LUNDRON KJO ANIJE**

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

**KREU III**

**Grafiku 15.** Nëse procedura për mbrojtjen shëndetësore primare, sekondare dhe terciare për personat me handicap është e qasshme ose lehtë e arritshme?



pikëpamje e personave me handicap është rezultat i faktit që personat me handicap zakonisht në vend që vet i ecin procedurat, ata i lënë që atë ta bëjnë të afërmit e tyre. Grafiku numër 15.

Një prej detyrimeve të shtetit në pajtim me KDPH është që t'u sigurojë qytetarëve me handicap mjete të përshtatshme

dhe cilësore ndihmë në mënyrë që ata të kenë lëvizshmëri më të madhe dhe të jenë të pavarur. Në këtë aspekt, në Grafikon 16 mund të shihet se 95.5% e të anketuarve konsiderojnë se shteti nuk ofron pajisje cilësore ortopedike, aparate dëgjimi për personat/fëmijët me handicap. Vetëm 4.5% janë shprehur se nuk e




## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE


Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU III

**Grafiku 16.** Sipas Jush, nëse shteti siguron pajisje ortopedike kualitative, aparate për dëgjim për personat/fëmijët me handicap?



**Grafiku 17.** Sipas Jush, nëse shteti siguron pajisje ortopedike kualitative, aparate për dëgjim për personat/fëmijët me handicap?



## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU III


dinë. Edhe në lidhje me këtë pyetje janë mendimet e ngjashme edhe te të anketuarit me handicap edhe te të anketuarit - prindër të fëmijëve me handicap.

Nga Grafiku numër 17 mund të shihet se përgjigjet me “nuk e di” këtu dominojnë te prindërit e fëmijëve me handicap.

Sa i përket pyetjes nëse ka transparencë dhe llogaridhënie nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor në pikëpamje të mjeteve që

ndahen për mbrojtje shëndetësore për personat me handicap, 90.5% e të anketuarve janë përgjigjur negativisht. Nga Grafiku numër 18 mund të shihet se 42% e personave me handicap konsiderojnë se FSSH nuk është transparent dhe llogaridhënës, për dallim nga prindërit ku pikëpamja e tyre është për 6.5% më e lartë. Përgjigjet me “nuk e di” dominojnë te personat me handicap, ku 8.5% e

**Grafiku 18.** Nëse ekziston transparencë dhe llogaridhënie nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor në pikëpamje të mjeteve që ndahen për mbrojtje shëndetësore për personat me handicap.





## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE


Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU III

KAH PO LUNDRON KJO ANIJE  
Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# KREU III

**Grafiku 19.** Nëse ekziston transparencë dhe llogaridhënie nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor në pikëpamje të mjeteve që ndahen për mbrojtje shëndetësore për personat me handicap



personave me handicap janë përgjigjur “nuk e di” në relacion me prindërit ku vetëm 1.5% janë përgjigjur me “nuk e di”.

Në Grafikon numër 19 mund të vërehet se në përgjigjet me “nuk e di” janë

mënjanuar personat me shikim të dëmtuar, ku 3.5 % prej tyre janë përgjigjur se nuk e dinë, dhe pastaj vijnë personat me handicap intelektuale me 2%.

## Deklarata e pjesëmarrësve nga fokus grupi dhe intervistat me palët e involvuara

- Unë jam person me dëgjim të dëmtuar dhe çdoherë duhet të shkoj me nënën time te mjeku. Konsideroj që secili institucion shëndetësor duhet të ketë nga një interpretues të shenjave.
- Çfarë qasje deri te mbrojtja shëndetësore primare ose çfarëdo që të jetë. Përmes terminit tim këta persona duhet të kenë përparësi dhe të sigurohet më shumë kohë tek specialistët. Vetëm për ta shëruar fëmijën – shkoi koha.
- Në institucionet shëndetësore të trajtojnë me atë se çfarë invaliditeti ke, ndërsa ti ke shkuar për dhimbje të barkut, dhe ata menjëherë të udhëzojnë te ortopedi. Kështu që duhet t’u dëshmohet se je për te ata. Deklaratë e një pjesëmarrësi të fokus grupit.
- Ka mjekë të cilët nuk kanë informacione për personat me handicap.
- Nuk janë të qasshëm motrat dhe mjekët. Ne nuk i kuptojmë dhe nuk është lehtë pa interpretues.
- Në fshat është shumë keq mbrojtja shëndetësore për këta fëmijë. Asgjë nuk është e qasshme dhe nuk ke ku të drejtohesh.



## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

## KREU III

KAH PO LUNDRON KJO ANIJE  
Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

## KREU III

- Vetëm në Shkup ka stomatolog për fëmijën. Nuk kam çka t'i bëj. Ndërsa shteti është i shurdhër për fëmijët me handicap.
- Unë nuk kam shtetësi dhe fëmija nuk ka sigurim shëndetësor. Nuk di as edhe ku të drejtohem.
- Nëse jeton në fshat, është shumë vështirë të kujdesesh për shëndetin e fëmijës. Është shumë vështirë edhe për ilaçe dhe për çdo gjë.
- Sistemi shëndetësor në vend është çdo ditë e më jofunksional, mungojnë kuadro, jo mjaftueshëm mendohet se si ai person të aftësohet dhe të përshtatet, personat me handicap janë lënë të vetëm.
- Në vendin tonë janë të nevojshme ndryshime të rëndësishme dhe drastike. I tërë sistemi dhe qasja shëndetësore duhet të ndryshojë. Së pari nuk ka asnjë lloj qasshmërie. Nuk ka njerëz. Motrat medicinale dhe mjekët nuk dinë as si t'i qasen as të komunikojnë me personat. Çdo gjë duhet të ndryshojë.
- Nëse flasim për institucionet shëndetësore, shpeshherë ashensori nuk punon, nuk ka shtretër të lira, madje edhe nëse dikush është me probleme respiratore, nëse ka ndonjë pluhur, kjo u pengon personave me handicap.
- Përvoja ime personale te mjeku: pres rend dhe thërrasin. Unë nuk i dëgjoj dhe pres me padurim tërë kohën dhe nuk ka kush të më thotë se mua më thërrasin.

- Nuk e di si janë procedurat: Babai dhe nëna më dërgojnë te mjeku kur ka nevojë. Ata shkojnë pas dokumenteve, kërkojnë njerëz.
- Shëndetësia është shumë keq, ka shumë probleme për shkak të mosprofesionalizmit të personelit mjekësor (4 vjet endemi nëpër institucione pa diagnozë) e cila edhe sot e kësaj dite është jo e plotë.
- Punëtorët shëndetësorë më duken të habitur sikur të mos jenë në gjendje të më ndihmojnë. Çdoherë janë me dyshim nëse jam për te ata.
- Që të fitohet çfarëdo dokumenti ka shumë procedura, komisione, ka shumë maltretime.
- Në shtet nuk ka doktorë, nuk ka transport të qasshëm. Madje nuk ka asgjë asgjë.
- Nuk ka diagnostikë. Do të të shëtisin, nuk mund të zbulojnë diagnozën në kohë për shkak të mungesës së aparaturës ose mungesës së ndërgjegjes nga ana e doktorëve ose shpesh bëjnë analiza jo të sakta dhe pastaj do të të thonë intervenim i shpejtë për në fund, është gabuar. Nuk ka asgjë. Çdo gjë duhet të ndryshohet.
- Në Maqedoni askush nuk dëshiron të merr përgjegjësi që të zbulohet gjendja në kohë. Ka një dezinformim shumë të madh, joprofesionalizëm, mosinteresim nga ana e kuadrit mjekësor. Do të duhesh vet të gjesh zgjidhje. Asgjë nuk kemi.



## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handikap në Republikën e Maqedonisë me vështirësi mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

## KREU III

KAH PO LUNDRON KJO ANIJE  
Demistifikimi i të drejtave të personave me handikap në Republikën e Maqedonisë me vështirësi mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

## KREU III

- Këto motrat patronazhe vetëm marrin para. Paramendoni 500 denarë vetëm për lidhje me fashë, e lidhja me fashë është aq sa për të lyer. Pastaj prindërit më rregullojnë, ndërsa ata janë më të moshuar. Nuk ka asgjë.
- Disa herë shkoj në Sllavej për të më marrë masën e këpucëve. Ndonjëherë nuk mund të më qëllojnë kallëpin, tash e 5 herë shkoj dhe ende duhet të paguajë 6.800 denarë për atë se kanë qenë më të larta për 5 cm. A bre ku ka kështu. Nuk ka transport dhe në çdo shkuarje udhëtoj Prilep-Shkup për këpucë, të cilat në asnjë mënyrë nuk mund t'i bëjnë. Shteti duhet të ketë më shumë qendra shëndetësore. Të specializuara për rritje dhe zhvillim. Të futen sa më shumë novitete nga lloji i Odës hipergarrike, qendra rehabilitimi.
- Të sillet ligj që do të ofrojë sigurim shëndetësor të personave mbi 26 vjet.
- Institucionet shëndetësore së pari të jenë të qasshme, dhe pastaj të pranojnë kuadro profesionale.
- Të gjithë personat me handikap të lirohen nga participimi të shoqëruarit në spital ose në banjë.
- Të formohen sa më shumë qendra rehabilitimi dhe të jenë falas për ne.
- Duhet të kihet kujdes më të madh nga ana e punëtorëve shëndetësorë ndaj personave me handikap. Personat me handikap duhet të kenë lirim nga çfarëdo lloj participimi për shërbimet shëndetësore dhe mjekimet.
- Kujdes më të madh për implantet kokleare, implant koklear falas, për zëvendësim të implanteve duhet të paguajmë 10.000 euro, ndërsa pastaj fondi të na kthejë, por prindërit nuk kanë të holla.
- Për fëmijët me dëgjim të dëmtuar të moshës parashkollore trajtim falas dhe bateri të implantuara kokeare (me aparate të vendosura) për personat me dëgjim të dëmtuar. Edhe është e nevojshme që personat shëndetësor të jenë të edukuar.
- Në shtet asgjë nuk është e sigurt! Këta fëmijë pranojnë terapi që nuk është në listën pozitive dhe prindërit e paguajnë tërë atë.
- Fëmija im është me pampersa sepse nuk ndjen. Pelenat i blej privat. Nuk po më takon. Nuk e di çka të them shëndetësia është shumë keq.

# KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME




**KAH PO LUNDRON KJO ANIJE**  
Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap  
në Republikën e Maqedonisë me vështirësi mbi të  
drejtën në mbrojtjen shëndetësore

## Konkluzione

- Edhe krahas ekzistimit të standardeve të forta ndërkombëtare që ndalojnë diskriminimin si dhe obligimet që vijnë nga KDPH legjislacioni kombëtar ende lë hapësirë për paqartësitë në lidhje me mospajtimin e mbrojtjes shëndetësore për personat me handicap.
- Legjislacioni në sferën e mbrojtjes shëndetësore nuk siguron qasje sistematike dhe të rrumbullakuar ndaj realizimit të drejtës në mbrojtje shëndetësore të personave me handicap pa diskriminim dhe në bazë të barabartë me të tjerët sipas Konventës për të Drejtat e Personave me handicap. Sipas hulumtimit, 94% e personave me handicap dhe prindërit e fëmijëve me handicap konsiderojnë që janë të diskriminuar në sferën e mbrojtjes shëndetësore.
- Sipas hulumtimit, 95,5% nga të anketuarit llogaritin që personat me handicap nuk janë të mbrojtur nga diskriminimi në sferën e shëndetësisë. Përderisa 5,5% kanë deklaruar që nuk e dinë. Edhe krahas asaj që pikëpamjet edhe të prindërve edhe të personave me handicap janë identike, megjithatë 48% nga prindërit janë përgjegjës negativisht në dallim të personave me handicap të cilët për 2,5% kanë raportuar për më pak.
- Institucionet nga sfera e shëndetësisë nuk kanë për obligim sigurim të qasjes në institucionet, e as për rregullim të përshtatshëm dhe të njëjtat nuk janë përgjegjëse për moszbatimin e pajustificuar gjë që paraqet mungesë serioze në luftën kundër diskriminimit të personave me handicap dhe krijimin e mundësive të barabarta. Sipas hulumtimit, 82,5% kanë deklaruar që institucionet nuk janë qasëse, përderisa 17,5% nga të anketuarit janë përgjegjës që pjesërisht janë qasëse. 43,5% të personave me handicap janë vendimtarë që institucionet shëndetësore nuk janë qasëse, përderisa 6,5% prej tyre konsiderojnë që institucionet janë pjesërisht qasëse. 11% nga prindërit e fëmijëve me handicap konsiderojnë që institucionet janë pjesërisht qasëse, përderisa vetëm 39% prej tyre konsiderojnë që institucionet shëndetësore nuk janë qasëse.





## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handikap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# Konkluzione

- Një nga pengesat kryesore për diskriminim ndaj personave me handikap në sistemin e mbrojtjes sociale është mungesa e ndërgjegjes kolektive dhe krijimi i shoqërisë ku personat me handikap do të kenë mundësi të barabarta.
- Shteti nuk siguron qasje deri tek shërbimet shëndetësore përkatëse dhe të pranueshme dhe mbështetje përkatëse në lidhje me gjendjen e aftësive të kufizuara dhe të njëjtat duhet të jenë të mbuluara nga ana e shtetit. Sipas hulumtimit, 94% nga të anketuarit konsiderojnë që procedurat për marrje të mbrojtjes shëndetësore primare, sekondare dhe terciare për personat me handikap nuk janë qasëse dhe lehtë të arritshme.
- Sipas hulumtimit 99% nga të anketuarit negativisht e kanë vlerësuar punën e punëtorëve shëndetësor në lidhje me qytetarët me handikap. Prej ku 41% nga të anketuarit kumulativisht kanë raportuar që puna e punëtorëve shëndetësorë është jo e mirë, 35,5% janë përgjigjur që nuk ju pëlqen, përderisa 23,5% konsiderojnë që është ajo që duhet. Vetëm 0,5% janë përgjigjur pozitivisht dhe % e njëjtë ka raportuar që nuk e dinë.
- Kualiteti ekzistues i mjeteve ndihmëse ortopedike dhe mjeteve tjera të cilat i siguron shteti nuk mundësojnë mobilitet më të madh te personat me handikap që të mund të fillojnë një jetë aktive dhe të pavarur. Sipas hulumtimit, 95,5% prej të anketuarve konsiderojnë që shteti nuk siguron mjete ndihmëse ortopedike kualitative, mjete ndihmëse për dëgjim për personat/fëmijët me handikap. Vetëm 4,5% janë përgjigjur që nuk e dinë.
- Sistemi ekzistues në shëndetësi bën diskriminim sistematik, si për moshën e personave me handikap ashtu edhe sipas bazës së tyre për arritjen e gjendjes me handikap. Dhe ashtu, varësisht prej asaj edhe personat me handikap arrijnë dhe mund të shfrytëzojnë beneficione të ndryshme nga sistemi shëndetësor.

## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handikap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# Konkluzione

- Vlerësimi i hyrjes të personave me handikap në sistemin e mbrojtjes shëndetësore bëhet në bazë mjekësore-defektologjike, që paraqet pengesë serioze për sigurim të mbrojtjes sociale dhe sigurim për personat me handikap.
- Praktika tregon që shteti nuk ndërmerr përpjekje të mjaftueshme për realizim të tërësishëm të obligimeve të ndërmarra me ratifikimin e Konventës për të drejtat e personave me handikap dhe avancimi është i nevojshëm me qëllim të realizimit efikas të të drejtave të personave me handikap.
- Nga sondazhet në hulumtimin, të anketuarit konsiderojnë që institucionet nuk janë transparente e as përgjegjëse në aspekt të mjeteve dhe beneficioneve të cilat i sigurojnë për personat me handikap. Sipas sondazheve 90,5% nga të anketuarit konsiderojnë që nuk ekziston transparencë dhe përgjegjësi të Fondit të Sigurimit Shëndetësor në aspekt të mjeteve të cilat ndahen për mbrojtje shëndetësore për personat me handikap.



## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# Rekomandime

- Legjislacioni kombëtar në sferën e mbrojtjes shëndetësore duhet tërësisht të reformohet në drejtimin për miratimin e saj të plotë me Konventën për të Drejtat e Personave me Handikap.
- Ndalimi i diskriminimit si dhe përshtatja e duhur mbi bazë të aftësive të kufizuara duhet qartë të përshkruhet në kornizën ligjore në të gjitha nivelet dhe pastaj e njëjta të zbatohet në të gjitha nivelet.
- Avancimi i Ligjit për sigurim shëndetësor dhe Ligjit për mbrojtje shëndetësore në drejtim të lejimit të personave me handicap të shfrytëzojnë, pa pagesë, kujdesin shëndetësor primar, sekondar dhe terciar sipas nevojës të lindur nga aftësitë e kufizuara.
- Zhvillim dhe miratim i legjislacionit për lloje të ndryshme të shërbimeve shëndetësore primare, sekondare dhe terciare e cila do të mundësojë nivel të lartë të qasjes dhe mbështetjes të personave me handicap për përfshirjen e tyre në komunitetin, si dhe kufizim dhe zhvillim të shërbimeve për rehabilitim dhe habitim dhe sigurim të shërbimeve me kualitet të barabartë.
- Ndryshimi i ligjit për sigurim shëndetësor, duke mundësuar shfrytëzim të vazhdueshëm pa kurrfarë kufizime të moshës për mjetet ndihmëse ortopedike me kualitet dhe funksionalitet më të lartë sipas nevojës së qytetarëve me handicap.
- Edukim dhe trajnim i domosdoshëm të personelit mjekësor për qasje dhe komunikim me qytetarët me handicap të shërbimeve patronazhe, si dhe atyre të cilët janë të përfshirë në spitalet psikiatrike.
- Vendosje dhe bartje të Politikës për sistem gjithëpërfshirës të shërbimeve shëndetësore për mbështetje me precizim konkret të instrumenteve për kontroll dhe koordinim. Më tej, duhet të zhvillohen dhe vendosen sisteme të reja dhe shërbime, si dhe profile të cilat do të dalin në ballafaqim me nevojat e qytetarëve me handicap.

## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# Rekomandime

- Është e nevojshme të ndërmerren masa të detyrueshme për buxhetim të politikave në mbrojtjen shëndetësore në bazë të aftësive të kufizuara në të gjitha nivelet.
- Që legjislacioni ta ketë efektin e dëshiruar, i njëjti duhet të jetë i shoqëruar me masa tjera plotësuese si, për shembull, ngritja e vetëdijes publike, ndërtimi i kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse dhe analizë detale të legjislacionit dhe politikave dhe avancimit të tyre përkatës.
- Nga sondazhet e hulumtimit rekomandohet që është e nevojshme inkorporimi i masave dhe politikave për fushata të vazhdueshme për ndryshimin e mentalitetit në nivel të shoqërisë. Me rëndësi vendimtare është shoqëria si tërësi, bartësit e vendimeve dhe të gjithë palët e interesuara, të përfshirë në sferën e mbrojtjes shëndetësore, tërësisht ta kuptojnë nevojën për ndryshimin e kësaj paradigme.
- Inkorporimi i obligimit për përfshirje të detyrueshme në Organizatat e persona me handicap dhe individët me handicap, si dhe vetë fëmijët me handicap. Pastaj, duke marrë parasysh të gjitha format e aftësive të kufizuara dhe balancin gjinor në krijimin e të gjitha programeve, masave dhe propozim aktiviteteve pa dallim se a janë aktivitete më të thjeshta dhe më të zakonshme në procesin e sigurimit të mbrojtjes shëndetësore.
- Ngritja e vetëdijes te personat me handicap dhe prindërve të fëmijëve me handicap për Konventën për të drejtat e personave me handicap, të drejtat e tyre dhe obligimet e shtetit të ndërmarra me ratifikimin e Konventës.
- Nga sondazhet e hulumtimit rekomandohet që është e nevojshme rritja e kapacitetit edhe të Organizatave të personave me handicap për përfaqësim dhe ndikim mbi politikat



## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# Bibliografia

“Të drejtat e pacientëve me fokus të personave me handicap intelektualë” ESE, 2011 faqe 6 <http://www.esem.org.mk/pdf/Publikacii/ESE%20Intelektualna%20poprecenost.pdf>.

“Shëndeti seksual dhe reprodaktiv dhe personat me handikap trupore – Raport nga vlerësimi për nevojat e shërbimeve – Hera,2012, <[http://hera.org.mk/wp-content/uploads/2014/02/izvestaj\\_poprecenost\\_rz.pdf](http://hera.org.mk/wp-content/uploads/2014/02/izvestaj_poprecenost_rz.pdf)> E arritur më: 21.10.2014, faqe 20

CRPD Committee (2014a) General Comment 1, Equal Recognition before the Law. Geneva.

[http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Zakon%20za%20zdravstveno%20oisguruvanje%20\(Interen%20precisten%20tekst\).pdf](http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Zakon%20za%20zdravstveno%20oisguruvanje%20(Interen%20precisten%20tekst).pdf)>

<http://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakonot-za-zashtita-na-pravata-na-patsientite-02-07-2008.pdf>>

Special Rapporteur (2005). On the right of everyone to the enjoyment of the highest attainable standard of mental and physical health, Paul Hunt, Report E/CN.4/2005/51.

WHO (2010a). Community-Based Rehabilitation: CBR-Guidelines Geneva (<http://www.who.int/disabilities/cbr/guidelines/en/>).

WHO (2012). Quality Rights Tool Kit([http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/70927/3/9789241548410\\_eng.pdf](http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/70927/3/9789241548410_eng.pdf))

## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handicap në Republikën e Maqedonisë me vështrim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# Bibliografia

Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Konventa për të drejtat e personave me handicap, A / RES / 61/106, nen. 25. E mundshme në:< <http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRPD/Pages/ConventionRightsPersonsWithDisabilities.aspx>>

Vëzhgimet përmbyllëse të Raportit inicial të Republikës së Maqedonisë nga ana e Komitetit për të Drejtat e Personave me Handikap, të miratuar nga ana e Komitetit në mbledhjen e 20-të (27 gusht - 21 shtator 2018). OKB Komiteti për të drejtat e personave me handicap. E gjeni në: < [https://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD/C/MKD/CO/1&Lang=En](https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD/C/MKD/CO/1&Lang=En)>

Ligji për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 82, e datës 08.07.2008) E gjeni në: <

Ligji për mbrojtje shëndetësore, Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/2012, 145/2012, 87/2013, 164/2013, MSH, e mundshme në:< [http://mz.gov.mk/wp-content/uploads/2012/12/zakon-za-zdravstvena-zastita-2\\_12\\_2012.pdf](http://mz.gov.mk/wp-content/uploads/2012/12/zakon-za-zdravstvena-zastita-2_12_2012.pdf)>

Ligji për Sigurim shëndetësor, (Teksti i konsoliduar i integruar Gazeta Zyrtare nr. 65/2012, 16/2013 dhe 91/2013) Fondi për sigurim shëndetësor, E gjeni në:<

Ligji për shëndet publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 136/2011 <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2012/12/zakon-za-javno-zdravje-precisten.pdf>

Ligji për ilaçet dhe mjetet ndihmëse mjekësore Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 11/2012 <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2012/12/zakon-za-lekovi-i-medicinski-pomagala.pdf>)



## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handikap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# Bibliografia

Ligji për shëndetin mental, Gazeta Zyrtare e RM nr. 71 2006. E mundshme në: <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/3549F74997B0084E9C47AC8F8A7423BC.pdf>>

Ligji për ratifikim të Konventës për të Drejtat e Personave me Handikap dhe Protokollin fakultativ ndaj Konventës për të Drejtat e Personave me Handikap, Kuvendi i RM. 2011, faqe 19 E gjeni në: <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/ED1FF6FC1C8A1F4A8F36F48EFDE95E55.pdf>>

Raporti nga ekspertiza e realizuar në Organizatën Publike Shëndetësore Spitali Psikiatrik “Shkup” – Shkup, Reparti për mbrojtje jashtëspitalore dhe avancim të shëndetit mental “Prolet” – Shkup dhe Spitali psikiatrik “Demir Hisar” 2006 faqe 2. E gjeni në: <<http://ombudsman.mk/upload/documents/JZO-mak.pdf>>

Instituti i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë – Raporti për shëndetin e banorëve në RM 2013, faqe 123, E gjeni në: <<http://prizma.birn.eu.com/>>

Komiteti i KB për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Komenti i përgjithshëm nr. 14: E drejta e standardit më të lartë të arritur për shëndetësi, E / C.12 / 2000/4 (11.08.2000). E gjeni në: <http://www2.ohchr.org/english/bodies/cescr/comments.htm> .

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, me amendamentet e kushtetutës I – XXXII“, NP Gazeta Zyrtare e RM, faqe 55, edicioni 2011, E mundshme në: <<http://www.slvesnik.com.mk/content/Ustav%20na%20RM%20-%20makedonski%20-%20FINALEN%202011.pdf>>

Rezoluta e miratuar nga ana e Asamblesë së përgjithshme të OKB më 13 dhjetor 2006, A/RES/61/106, 24 janar 2007. E gjeni në: <[https://treaties.un.org/doc/source/docs/A\\_RES\\_61\\_106-E.pdf](https://treaties.un.org/doc/source/docs/A_RES_61_106-E.pdf)>

## KAH PO LUNDRON KJO ANIJE

Demistifikimi i të drejtave të personave me handikap në Republikën e Maqedonisë me vështirim mbi të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

# Bibliografia

Organizata Botërore e Shëndetësisë, “Definicioni për shëndetin”. E gjeni në: <<Http://www.who.int/about/definition/en/print.html>.>

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut – Raporti nga vizita e institucioneve speciale dhe spitaleve psikiatrike në R. Maqedonisë për vitin 2011 dhe 2012. E gjeni në: <<http://www.mhc.org.mk>>

Handikap – mozaiku që mungon – Pasqyrë e gjendjes së personave me handikap, 2012 Polio Plus – lëvizja kundër handikapi, faqe 60-64, [www.polioplus.org.mk](http://www.polioplus.org.mk)).

## **Polio plus – lëvizja kundër handiklapit**

Polio Plus është organizatë maqedonase multietnike, multikonfesionale qytetare e personave me dhe pa handikap e cila punon në lidhje esenciale dhe realizimit të plotë të së drejtave dhe lirive themelore të personave me handikap.

Misioni ynë është përforcimi i besueshmërisë të personave me handikap dhe krijimin e shoqërisë me mundësi të barabarta për të gjithë.

Misionin e realizojmë nëpërmjet përfaqësimit dhe lobimit për ndryshime dhe menaxhim të legjislacionit, arsimit, punësimit dhe jetës së pavarur të personave me handikap nga njëra anë, si dhe ngritjes së vetëdijes publike, afirmimit të kreativitetit të tyre dhe kontribut në bashkësi nga ana tjetër.

“Polio Plus nuk udhëton vetë”. Misionin tonë e realizojmë së bashku me faktorë tjerë të shoqërisë.

### **Kontakt**

Polio Plus – lëvizje kundër handiklapit

Bulevar Avnoj 64 lokal 2

1000 Shkup, Maqedoni

Telefon/faks: +389 2 2400 544

E- posta: [polioplus@polioplus.org.mk](mailto:polioplus@polioplus.org.mk)



# MARGINA OBSCURA



Agency for Cooperation, Education and Development



**Polio Plus**

Lëvizje kundër handikapit